

Thirrje e hapur për dorëzimin e punimeve artistike në temën

AFËRSIA E NGUSHTË

ÇFARË NËNKUPTON AFËRSIA E NGUSHTË PËR JU?
KU QËNDRON KJO AFËRSI E NGUSHTË NË JETËN TONË TË PËRDITSHME?
SI E PËRMIRËSON AFËRSIA E NGUSHTË JETËN TONË?
CILAT JANË PENGESAT E AFËRSISË SË NGUSHTË?

Foto: Tim Marshall

Nëse jeni kreativ dhe jeni të interesuar për temën, nëse jeni të gatshëm të kontribuoni dhe t'i shkëmbeni mendimet dhe idetë tuaja me ne, dhe nëse jeni nga zonat që mbulohen nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Misioni i OSBE-së në Serbi, na dërgoni **maksimalisht tre vepra arti vizuale përmes postës elektronike deri më 14 shtator 2020!**

Thirrja është e hapur për të gjithë, pavarësisht gjinisë apo moshës. Për të marrë pjesë, nuk është e domosdoshme të jesh artist profesionist! Ne mirëpresim mendimet dhe perspektivat tuaja mbi temën. Veprat e përzgjedhura do të janë pjesë e një ekspozite që synon të nxisë bashkëpunimin midis të rejave dhe të rinjve të interesuar në arte, ndërkohë që njëkohësisht promovohen vlerat e '**afërsisë së ngushtë**'. Ekspozita do të prezantohet në rrjetet sociale të Akademisë së Dialogut me mbështetjen e DokuFest.¹

Tre veprat e përzgjedhura si më të mirat do të fitojnë çmime të vlefshme. Me dërgimin e veprave, pjesëmarrësit deklarohen se punimi apo punimet janë pronë e tyre intelektuale dhe se pranojnë që puna e tyre do të përdoret për qëllime promovimi.

SI TË APLIKONI?

Dërgoni një email në **oscedialogueacademy@gmail.com** me maksimalisht tre punime të dorëzuara për person, që përbajnjë përshkrin/mesazhin/sloganin e veprës tuaj artistike (deri në 5 fjali), së bashku me të dhënrat tuaja personale (emrin, adresën, numrin e telefonit, emailin dhe disa rreshta për veten). Ne jemi të hapur të pranojmë vepra arti vizuale siç janë fotografia, arti dixhital 2D, art video, art interaktiv dhe piktura që trajtojnë temën e bashkësisë. Për më shumë informacione, ju lutemi na dërgoni email me pyetjet tuaja.

Akademia e Dialogut për Gratë e Reja është pjesë e nismës "Na Ndiqni" të mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Misioni i OSBE-së në Serbi. Akademia bashkon dhe fuqizon gra të reja nga Prishtina dhe Beograd duke i edukuar ato për çështje që lidhen me rolin e grave në promovimin e dialogut, pajtimit dhe bashkëpunimit.